



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA**

C.nr.103/2010

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË.** Gjuqtari Ragip Kadriu në çështjen juridike të paditësit: *ie* Prishtinë, të cilin e përfaqëson nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditurit: rr."Ulqini" p.nr., për shkak të borxhit, vlera e lëndës së kontestit 115.35 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të dt:14.02.2017, me dt:03.03.2017 jep këtë:

**A K T G J Y K I M**

**OBLIGOHET**, i padituri nga Mitrovica, që t'i paguaj paditësit: në Prishtinë, në emër të borxhit shumë prej 115.35 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

**A R S Y E T I M**

Paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurit për shkak të borxhit në shumë prej 115.35 Euro, duke theksuar se paditësi me të paditurin me dt:19.06.2009 kanë nënshkruar Kontratë për Pagimin e Borxhit me Këste, për shfrytëzimin e shërbimeve të telefonisë fikse për numrin e telefonit 028536514.

Edhe përkundër nënshkrimit të kontratës i padituri nuk i ka përmbushur obligimet e veta të pranuar në kontratë.

Përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor mbeti në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë me përjashtim të kamatës, duke i propozuar gjykatës që të njejtën ta aprovoj si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoi.

Gjykata, seancën e shqyrtimit kryesor e mbajti në mungesë të të paditurit, konform nenit 423.4 të LPK-së.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe të nevojshme dhe pas administrimit dhe vlerësimit të të njejtave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në procedurën e provave lexoi: Kontratën Për Pagimin e Borxhit me Këste, e dt:19.06.2009 dhe konstatoi këtë gjendje faktike:

Nga kontrata e sipërcekur konstatohet se: I padituri ka pranuar kushtet e përgjithshme të kontratës, ku i njejtë ka marrë për obligim që borxhin e sipërcekur ta paguaj me këste mujore duke filluar nga dt:01.06.2009 e gjerë më dt:01.10.2009.

Nga deklarata e të autorizuarit të paditësit rrjedh se i padituri nuk e ka përmbushur obligimin e tij sipas kontratës së sipërcekur.

Konform nenit 17 al.I të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Detyrimore (i vjetër) i aplikuar në rastin konkret e konform nenit 1057 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr.04/L-077) është përcaktuar se: palët në marrëdhënien detyrimore janë obliguar t'i përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njejtave.

Duke bërë interpretimin e kësaj dispozite ligjore rrjedh se: në rastin konkret palët kanë lidhur kontratën e sipërcekur dhe me vullnetin e tyre të lirë kanë pranuar kushtet e përgjithshme të kontratës, mirëpo i padituri nuk i ka përmbushur obligimet e veta të pranuar me këtë kontratë, prandaj gjykata të njejtin e obligoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore bazohet në dispozitën e nenit 10.1 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, duke i njohur paditësit shpenzimet në emër të taksave gjyqësore për padi dhe vendim, shumë prej 30 Euro.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.nr.103/2010, me dt.03.03.2017

G j y q t a r i  
Ragip Kadriu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës e përmes kësaj gjykate.